



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 64/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike, (rrethrotullime), në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, ashtu që Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2150 (dymijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për të u dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 26.04.2012, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK, me datën 25.04.2012, nga ora 07:00 në udhëkryqin Rruga “Rexhep Bislimi”, me kryqëzim të Rrugës “Dëshmoret e Kombit”, si dhe në udhëkryqin Rrugës “Pleshinës”, në të dy rrethrotullimet janë vendosur posterët e kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt Adem Salihaj nga radhët e subjektit politik të LDK-së. Në këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi për pretendimet e paraqitura në ankesë.

### Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK, më datë 26.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 27.04.2012 në ora 16:00. PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar.

## **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe neni 3 paragrafi 1 pika (b) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) Nr. 11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:*

*b) vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterave, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

## **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

PZAP-i, përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ndaj këtij subjektit politik ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografit e dorëzuara si provë e që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për kryetarë të komunës së Ferizajt, Adem Salihaj nga radhët e subjektit politik LDK, janë të vendosura në rrugët publike (rrethrotullime), veprim të cilin PZAP-i i konstaton se janë në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën, mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. PZAP-i konstatoi së në rastin konkret nuk pati rrethana lehtësuese ndërsa si rrethana rënduese gjeti se subjekti politik LDK shkeljet e *Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* i ka përsëritur andaj konsiderohet si recidiviste e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjohë. Nga të gjitha arsyet e sipërshënuara dhe më qëllim të evitimit të shkeljeve të pretenduara ankesë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 64/2012 më datën 28.04.2012

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

